

Lufta kurative ose larvicide.

Trajtimi duhet bere gjate Shtatorit, kur infekzioni ka arritur 10-15% ne veze dhe larve .Zakonisht perdoren preparate me lende active pak te treteshme ne yndyrna.

Trajtimet duhet te kryhen menjehere perpara se shumica e larvave te arrijne ne moshen e trete.Per trajtimet e fundit se paku 20 dite para vjeljes duhen perdorur preparate fosfororganike duke respektuar periudhen e pritshmerise sepse te gjithe preparatet qe gjenden ne treg jane pjeserisht te tretshem ne vaj.Sperkatjet duhet te behen me mjete te pershtateshme, ne kohe pa ere, solucioni sperkates te shperndahet uniformisht ne menyre qe te lagen te gjitha kokrrat e ullirit.Lendet active te keshilluara jane : Dimetoat = Rogor 0.2%, Fosfamidon =Dimecron 0.1-0.2%, Triclorfon = Dipterex 0.3-0.5%,



Fermere

Merrni masa ne kohe per te parandaluar demin qe mund te shkaktoje miza e ullirit.Mundi dhe djersa e gjithsecilit qe merret me kultivimin e ullirit mund te shkoje dem ne rast se nuk vleresohet kontrolli I ketij demtuesi te rrezikshem. Afati per trajtimin e ullirit ka ardhur.

Bashkepunoni me specialistet e buqesise per te percaktuar momentin e duhur te nderhyrjes me trajtime.

Mos harroni se. te trajtosh ne momentin e duhur, kursen me shume leke, perfiton nje efikasitet te larte te trajtimit, ul ne menyre te ndjeshme dinamiken e popullates te demtuesit,siguron nje vaj me sa me pak mbetje pesticidesh, mbron ambientin dhe biodivesitetin ne per gjithesei.

Kjo flet palosje u perqatit nga:

**Agr. Mendim Bacaj. Specialist I mbrojtjes se bimeve
prane QTTB-Vlore
Cel 0682209469**

**Qendra e Transferimit te Teknologjive
Bujqesore- Vlore**

Praktikat qe perdoren per mbrojtjen e prodhimit te ullirit nga miza e ullirit
(Bractocera Oleae).



QTTB Vlore

Tel 033404145

E-mail qttpemtarivlore@yahoo.com

Sistemi i kontrollit

I-Monitorimi dhe kufiri kritik.

-Monitorimi i insekteve te rritura behet ne-permjet kurtheve te tipeve te ndryshme si kurthe kromotropike (ngjyre te verdhe) ne te cilet mund te jene vendorosur se bashku feromone seksuale+proteina te hidrolizuara+kriperat e amonit. Kurthet jane te lyera me nje ngjites dhe jane te afte te kapin insektet e rritur meshkuj dhe femra. ,kurthe te paisura vetem me feromon (ngjyre te celur)Zakonisht perdoret fero-moni Spiroketal dhe ndertimi i tyre eshte ne forme rombi

- Kufijte e nderhyrjes:
- Per ullinje per tavoline ; kur verehen cpimet e para
- Per ullinje per vaj; 10-15% te infeksionit
- Metoda e kapjes massive qe konsiston ne vendosjen e Ekotrapeve ne cdo peme ne fillim te muajit Shtator.

Miza e ullirit (*Bractocera oleae*)



Miza e ullirit Perfaqson demtuesin kyc te kesaj kulture.Perhapsja dhe shkalla e demit te ketij insekti nuk eshte e njeje ne te gjithe zonat e kultivimit te ullirit.Numeri me i larte i breznieve dhe demtimet me te medha verehen ne zonen bregdetare, ndersa ne zonen e brendeshme te kultivimit te ullirit demet jane me te vogla. Gjithsesi ky demtues shkakton ulje te ndjeshme te prodhimit ne ato raste kur nenvleftesohet kontrolli i tij.Monitorimet e vazhdushme dhe ndjekja e niveleve te infeksionit jane vendimtare per te percaktuar momentet me te pershtateshme per nderhyrje dhe mbajtjen ne nivele te pranushme te infeksioneve nga ky demtues

Kontrolli kimik

Lufta preventive ose adulticide

Ne kuadrin e luftes kimike, si alternative e luftes kurative ose larvicide rekomandohet te aplikohet gjithashtu lufta preventive ose adulticide. Metoda eshte bazuar ne per-dorimin e proteinave te hidrolizuara (eshk-kat) te cilat kane vecorine e terheqjes se insekteve te rritura

Pergatitja e eshkave proteinike.

Ne 1 kg. protein te hidrolizuar (Buminal) + 150-200 gr. Dimetoat ose 250 gr fention, ose 100 gr. Decis./ 100 litra uje. Me kete solucion sperkatet 1 meter katror nga lindja cdo 21 dite.

Ne 30 litra uje tretet 1 liter preparat Success 0.24 CB. Perdoret 300 gr solucion duke trajtuar anen lindore te pemes.Trajtimet perseriten cdo 21 dite.

Metoda e luftes preventive eshte e rende-sishme edhe nga pikepamja ekologjike dhe toksikologjike per sasine e ulet te pesti-cideve te perdonura(rreth 10 here me pak se ne metoden kurative.